

LEONARD DAUTI

RRETH EMËRZIMIT KONTEKSTUAL TË MBIEMRIT NË GJUHËN SHQIPE

Në studimet tona gjuhësore ka zënë vend mendimi se kemi dy lloj emërzimesh: *emëzimit të qëndrueshëm* (mbiemri ka kaluar përfundimisht në klasën e emrit) dhe *emëzimit kontekstual* (mbiemri përdoret si emër në një kontekst të caktuar ligjërimor) (Dhrimo, 1971:82; GA, 2002:182). Mbi bazën e këtij dallimi mund të veçohen dy grupe mbiemrash të emëruar: (i) mbiemrat që kanë kaluar në emra, si *e mira, e keqja, e shëmtuara, e veja* etj.; (ii) mbiemrat që shfaqen si emra brenda një konteksti të caktuar. Ky grup i dytë nuk është homogjen. Në të mund të veçohet një grup mbiemrash të cilët emërzohen brenda një teksti të dhënë (konteksti gjuhësor, pavarësisht situatës së komunikimit) dhe një grup tjetër mbiemrash të cilët emërzohen në një situatë të caktuar komunikimi. Dallimin midis tyre e ka vërejtur i pari Dhrimoja, kur për mbiemrat e emëruar në një situatë të caktuar komunikimi thekson se “mëvetësia emërore e mbiemrit të substantivuar, megjithëse është kontekstuale, okazionale, është shumë më e madhe sesa në rastin kur emri është përmendur një herë gjatë ligjërimit; ...” (Dhrimo, 1971:87). Pavarësisht kësaj vërejtjeje ai nuk i ka dalluar ata si grup i mëvetësishëm. Ne do t’i dallojmë si grup të veçantë, pasi edhe emërimi i tyre shfaq karakteristika të ndryshme. Prandaj, do t’i përmbahemi ndarjes në tri grupe:

(i) mbiemra që emërzohen brenda një rrethimi të caktuar gjuhësor (emra kontekstualë);

(1) *Plakun njëqindvjeçar e pyeti:*

- *Ku i ke djemtë?*

- ***I madhi*** është vrarë në Drenicë. ***I vogli*** kapi pushkën. *Te Ura e Shenjtë po lufton.* (Rexhep Ferri, *Njeriu, po kush tjetër*, 1999-2001)

(ii) mbiemra që emërzohen në një situatë të caktuar komunikimi (emra situativë);

(2) *E pyeta ç’kërkonte e më tha se të mërkurë, më desh me limuzinë në Washington.*

- ***I madhi*** i partisë tonë vjen nga Tirana e do që të takojë të mëdhenjtë e këtushmë, – tha. – *Ti do vidh me mua e do të mbaj atje.* (Pëllumb Kulla, *Rrëfenja nga Amerika*, 2000-2011)

(iii) mbiemra, emërzimi i të cilëve nuk është i kushtëzuar nga konteksti gjuhësor apo nga situata komunikuese. Këta mbiemra kanë kaluar në emra (emra prejmbiemërorë) (Karapinjalli & Luniku, 2011:45);

- (3) *Ose, është edhe një mundësi që vendin ta bëjmë të bukur: nëse punët e mbrapshta e shëmtitë i fusim në kategorinë e vlerave të këtij vendi. Se ku kam lexuat se edhe tek e keqja, tek e shëmtuara, ka estetikë. Në një situatë të tillë, do të ishim të parët. ("Zëri ...", 24.08.2013)*

Ndarja jonë nuk bazohet në shkallën e ngulitjes dhe të qëndrueshmërisë së kalimit të mbiemrit në kategorinë emërore (Dhrimo, 1971:82), por në pjesëmarrjen e proceseve gramatikalizuese dhe leksikalizuese gjatë substantivimit të mbiemrit, duke dalluar në grupin e parë gramatikalizim në kushte të caktuara ligjërimore, ndërsa në të dytin dhe të tretin leksikalizim në shkallë të ndryshme të mbiemrit të emëruar.

Për emërzimin e mbiemrit nuk vepron ndonjë kushtëzim leksikor, pasi të gjithë mbiemrat mund të emërzohen (GA, 2002:182). Por, duke qenë se mbiemri emërzohet vetëm në disa marrëdhënie të caktuara brenda fjalisë (marrëdhënie atributive), atëherë duhet t'i përgjigjemi pyetjes: *Përse dhe në ç'rrethana ndodh emërzimi i mbiemrit? Këtë pyetje mund ta shtrojmë edhe ndryshe: Në rastin e emërzimit të mbiemrit, kemi të bëjmë me një rregullsi të diktuar nga rrethana të caktuara ligjërimore, apo me një dukuri subjektive, e cila mund të shihet si "akt i krijimit individual të fjalëve në rrethana të caktuara"* (Dhrimo, 1971:86; Buchholz & Fiedler, 1987:343; GA, 2002:182), *dhe i motivuar kryesisht nga shkaqe stilistike për të shmangur përsëritjen e emrit të përmendur më parë?*

Me pyetjen kryesore që kemi parashtruar lidhen edhe një sërë pyetjesh të tjera, sqarimi i të cilave do të mund të na japë një pamje sa më të plotë të dukurisë së emërzimit.

Nëse pranojmë se të gjithë mbiemrat e gjuhës shqipe e kanë aftësinë për t'u emëruar (GA, 2002:182), nga buron kjo aftësi e tyre për emërim? Kemi të bëjmë me një tipar të qenësishëm të klasës së mbiemrave, apo ajo kushtëzohet nga kushte të caktuara ligjërimore e sintaksore?

Për të dhënë një përgjigje sa më të argumentuar dhe të pranueshme për këto çështje, na duhet të përcaktojmë së pari natyrën e njësisë gjuhësore të përfutur me anën e emërzimit dhe mekanizmin përkatës që ka vepruar për krijimin e saj. Do të nisemi nga të dhënat gjuhësore dhe interpretimi i tyre për të arritur te zbulimi i mekanizmit që ka vepruar dhe vepron për përfutimin e 'emrave kontekstuale'.

Gramatikat kryesore të gjuhës shqipe ndahen në lidhje me qëndrimin ndaj përkatësisë leksiko-gramatikore të njësisë së përfutur si rezultat i

emërzimit¹. Nga njëra anë, kryesisht në gramatikat e hershme, në të cilat dukuria e emërzimit nuk trajtohet, mbiemrit i njihet kategoria e shquarsisë (Kristoforidhi, 2001:87; Frashëri, 1988:126; Pekmezi, 1908:105; Sheperi, 1927:49; Cipo, 1949:71). Edhe Sheperi, i cili e vëren përdorimin e mbiemrit si emër, përsëri dallon mbiemrat e shquar, duke theksuar që “këta janë mbiemra që përdoren si emra” (1927:131), madje pohon edhe që “mbiemri i shquar përdoret gjithmonë si emër” (1927:140). Nga ana tjetër, pranohet që mbiemri është emëruar dhe si i tillë shfaq kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës e shquarsisë (Cipo, 1949:71; Camaj, 1984:41; Resuli, 1985:208; Buchholz & Fiedler, 1987:343; GA, 2002:182). Një përcaktim mjaft interesant e ndeshim te Justin Rrota, i cili nënvizon se “ata rrijn në kambë t’emrit, dhe veshin natyrën e substantivit, tue rrujtë gjithënjë trajtën mbiemërore a gramatikore të vetën” (2006:251). Një pohim të tillë pjesërisht e ndeshim edhe në “Gramatika e gjuhës shqipe 1”, kur pohohet se kategoria e gjinisë dhe e numrit të mbiemrit të emëruar nuk janë të mëvetësishme, ato i përkasin emrit të nënkuptuar (GA, 2002:183).

Ne do të përkrahim mendimin se në këtë përdorim nuk kemi emra, por mbiemra të përdorur në një pozicion të veçantë sintaksor që nuk është tipik për mbiemrin. Ndër argumentet në mbështetje të këtij qëndrimi, përveç pohimeve të autorëve të cituar më lart, do të veçonim: i) ruajtja e aftësisë për t’u markuar nga treguesit e shkallës; ii) mungesa e kundërvënies formë e markuar – formë e pamarkuar²; iii) ruajtja e lidhjeve sintaksore tipike për mbiemrin.

“Aftësia” e mbiemrit për të marrë modifikues të ndryshëm, të cilët përcaktojnë një shkallë të caktuar të sasisë, cilësisë apo të intensitetit të tiparit të shënuar prej tij, ruhet edhe në rastin kur ai del i emëruar.

¹ Çështja e përkatësisë leksiko-gramatikore nuk shtrohet për emrat prejmbiemërorë. Ata janë emra, leksema emërore që kanë pasuruar klasën e emrave. Ne këtu do të diskutojmë për njësitë e përfuara në rastet e tjera të emërzimit, ato të cilat shfaqen vetëm në një kontekst të caktuar gjuhësor, që ne i kemi cilësuar paraprakisht si mbiemra-emra.

² Në gramatikat e gjuhës shqipe përgjithësisht bëhet fjalë për kundërvënien trajtë e shquar – trajtë e pashquar. Te format e trajtës së pashquar të emrit përfshihet edhe forma e zhveshur nga treguesit gramatikorë, e tipit djalë, njeri, zë etj. Ne këtë formë të zhveshur nga treguesit gramatikorë e konsiderojmë si formë të pamarkuar të emrit, e cila nuk karakterizohet nga tipari i shquarsisë/pashquarsisë. Në rastet kur përdoret në një tekst të caktuar, semantika e emrit të pamarkuar është e barabartë me kuptimin leksikor të tij: Unë nuk kam vëlla. Kjo formë është e paaftë të krijojë një lidhje referenciale dhe prandaj është e pakuptimtë të flasim për kuptim të pashquarsisë.

- (4) *Shtuni qeshi, sepse mesa duket pjesa më e vështirë e tregimit të tij kishte mbaruar. Më e rëndësishmja kaloi, tha me vete dhe iu drejtua Enverit.* (Blushi, *Shqipëria*, 2011:569)

Ruajtja e kategorisë së shkallës dëshmon që mbiemri ka ruajtur një ndër tiparet dalluese të klasës së vet. Shkalla, si tipar i mëvetësishëm³ i mbiemrit, shënon pikërisht atë që Rrota e quan “trajtë mbiemërore a gramatikore të vetën”.

Nëse kuptimi i shkallës është i rrokshëm lehtësisht, kundërvënia formë e markuar – formë e pamarkuar shfaqet më e ndërlikuar. Mbiemri i emëruar del gjithmonë i markuar nga treguesit e shquarsisë ose të pashquarsisë, që do të thotë se ai zë vendin e një emri të markuar. Në (5b) vërejmë se mbiemri nuk mund të dalë i pashquar me emrin e pamarkuar, pra nuk mund të zërë vendin e tij, ndërsa në (5c) ai del në vend të emrit të markuar (i shquar), duke u bashkuar me treguesin e shquarsisë.

- (5) a. *Ndërkohë nga burime të besuar mësohet se ka qenë vetë zyra e Fratinut nga Brukseli që ka kërkuar makinë të **blinduar**, shtim të forcave të sigurisë dhe çuditërisht edhe një menu të kontrolluar dhe të përzgjedhur të ushqimit.* (“Gazeta Shqiptare”, 18.11.2006)
- b. **Ndërkohë nga burime të besuar mësohet se ka qenë vetë zyra e Fratinut nga Brukseli që ka kërkuar makinë të **blinduar**, shtim të forcave të sigurisë dhe çuditërisht edhe një menu të kontrolluar dhe të përzgjedhur të ushqimit.*
- c. *Njeriu i mirë, pa marrë parasysh çka është, mbetet i mirë, ndërsa i keqi mbetet i keq, themel e kulm.* (“Zëri...”, Dw (përmes “Zëri...”), 29.07.2013)

Arsyeja pse në (5b) nuk mund të kemi emëzim, ndërsa në (5c) mund të kemi, lidhet me funksionin e ndryshëm tekstor të dy sintagmave. Në rastin e parë, emri i pamarkuar (*makinë*) nuk është në gjendje të krijojë i vetëm një lidhje të re referenciale⁴ në tekst. Lidhja referenciale krijohet prej krejt grupit emëror (*makinë e blinduar*). Mungesa e emrit bën që referenca të mos realizohet, pasi konstruksioni nuk i ka treguesit e nevojshëm gramatikorë për ta realizuar atë (5b). Në rastin (5c) lidhja

³ Shkallë ka edhe ndajfolja, e ne mund të flasim edhe për shkallë të emrit. Por nuk do të merremi me këtë çështje këtu. Kur themi “tipar i mëvetësishëm”, nënkuptojmë që ky tipar nuk diktohet nga emri me të cilin mbiemri shoqërohet, por nga vetë natyra e tij.

⁴ Me lidhje referenciale do të shënojmë lidhjen midis njësisë gjuhësore dhe referentit të botës jashtëgjuhësore.

referenciale përcaktohet prej një grupi emëror të caktuar në tekst; mbiemri i emëruar vetëm e rimerr atë dhe kjo rimarrje sinjalizohet përmes treguesit të shquarsisë *i keq-i – njeriu*.

Rasti më i zakonshëm i emërzimit të mbiemrit është dalja e tij në pozicionin e emrit të shquar, si p.sh.:

<i>çupa e madhe</i>	<i>e madhja</i>
<i>vajza e bukur</i>	<i>e bukura</i>
<i>njeriu i panjohur</i>	<i>i panjohur⁵</i>
<i>djali i vogël</i>	<i>i vogli</i>

Ka edhe raste kur mbiemri i emëruar del në formë të pashquar, i shoqëruar nga nyjat joshqese *një, ca, disa* ose nga caktuesorë të tjerë (6a).

- (6) a. *Na ish njëherë një i mirë me mall e gjë shumë e na bënte dasmën e të birit.* (Kuteli, *Vepra letrare 2*, 1990:226)
- b. *Im zot bën dasmën e bandillit e fton të madh e të vogël të vije e të gëzohet në shtëpinë e tij!*
Edhe gjithë kjo botë – i mirë e i lik, i madh e i vogël, burrë e grua – ngrinte njato plloska të rënda, vështjellë me borzilok e me trëndelinë të thatë edhe uronte: ... (Kuteli, *Vepra letrare 2*, 1990:226)

Rasti (6b) duket se dëshmon kundër asaj që kemi theksuar më lart, se mbiemri nuk mund të emërzohet kur shoqëron një emër të pamarkuar. Ky është një nga rastet e rralla të një përdorimi të tillë, i cili është karakteristikë e gjuhës së folur. Më tepër këtu kemi të bëjmë me një përdorim idiomatik, pasi nuk mund të kemi përdorim të mbiemrave të emëruar jashtë bashkëvajtjes antonimike bashkërenditëse (7).

- (7) **Edhe gjithë kjo botë – i mirë, i vogël, burrë e grua – ngrinte njato plloska të rënda, vështjellë me borzilok e me trëndelinë të thatë edhe uronte: ...*

⁵ Në këtë rast *i* -ja nuk i përgjigjet *u* -së së emrit përkatës *njeriu*. Kjo kushtëzohet nga rrethimi fonologjik. Mosruajtja e së njëjtës formë tingullore në rrethime të ndryshme fonologjike është një argument në të mirë të trajtimit të tyre si alomorfe, përkundër mendimit se këtu kemi të bëjmë me dy morfema të ndryshme (Memushaj, 2012:80). Por këtu nuk do të zgjatemi mbi këtë çështje, pasi del jashtë objektit të punimit tonë.

Pranimi i kalimit të mbiemrit në “emër kontekstual” do të kërkonte respektimin e kundërvënies formë e markuar – formë e pamarkuar, gjë që nuk ndodh. Madje, edhe kundërvënia *trajtë e shquar – trajtë e pashquar* pasqyron shquarsinë/pashquarsinë e sintagmës determinative (SD) përkatëse (shih më poshtë). Mund të ndodhë që mbiemri të dalë në një pozicion në formë të shquar dhe në një tjetër në formë të pashquar, i paraprirë nga treguesit e pashquarsisë, por këto duhen parë si raste të përdorimit të mbiemrit në konstrukte të natyrave të ndryshme. Në një rast konstrukti e kërkon kokën emërore në formën e shquar dhe në një rast tjetër në formën e pashquar.

Përveç dy argumenteve të mësipërme, mund të përmendim edhe faktin që klasat e fjalëve që mund të dalin si modifikues të mbiemrit të emëruar janë të njëjta me ato me të cilat shoqërohet zakonisht mbiemri, por edhe emri përkatës.

- (8) *një djalë krejt i habitur* – **krejt i habituri**
vajza më e bukur e grupit – **më e bukura e grupit**

Përveç tipareve të mësipërme të cilat i japin atij statusin e mbiemrit, mbiemri i emëruar mund të marrë modifikues mbiemërorë ose fjali nënrenditëse përcatore, gjë që i jep atij statusin e emrit:

- (9) a. *Qytetarët e duan një shtëpi të vogël teksa po shembet kjo e madhja.*
 (“Zëri ...”, 22.05.2013)
 b. – *hmm, ëndrra. Ka shumë por mëe madhja e çdo artisti besoj që është t’i arrish majat e muzikës.* (“zëri ...”, 29.08.2013)
 c. *Sa për të voglën që kishte lindur në han, në shtëpi të botës, mes jabaxhinjve e që akome s’e kishin pagëzuar (përkohësisht e thërrisnin Fatkeqe); ...*

Manifestimi i tipareve mbiemërore, nga njëra anë, dhe i atyre emërore, nga ana tjetër, dëshmon se njësia e re e përfutur gjendet sa në klasën e mbiemrave, po aq edhe në atë të emrave.


Ajo që vërehet është se mbiemri, duke dalë në pozicionin e emrit, bashkohet me treguesit gramatikorë të tij, të cilët markojnë kategori gramatikore të caktuara (gjini, numër, rasë, shquarsi/pashquarsi). Në këtë mënyrë, ai bëhet përçues edhe i tipareve gramatikore që nuk i përkasin atij vetë, por emrit. Kjo nuk është rezultat i kalimit të mbiemrit në klasën e emrit, por bashkim i mbiemrit me treguesit gramatikorë të emrit si rezultat i lëvizjes së tij drejt pozicionit ku emri do të duhej të bashkohej me treguesit e shquarsisë – pozicionit D°.

Motivimi i emërzimit të mbiemrit si pasojë e shmangies së përsëritjes së emrit duket se nuk vërtetohet në të gjitha rastet. Këtë e ka vërejtur i pari Cipoja, kur nënvizon se mbiemri nuk quhet i substantivuar “kur nënkuptohet emri me të cilin shkon ai” (1949:71). Shembulli që sjell Cipoja:

(10) *Me armiqtë i kish të hidhëta fjalët, me miqt, t'ëmblla.* (vep. cit.)

mendojmë se duhet interpretuar dhe motivuar ndryshe. Emri me të cilin “shkon” mbiemri nënkuptohet në të gjitha rastet e emërzimit, pasi në të gjitha rastet kemi veprim të elipsës mbi emrin, ose, po të shprehemi me termat e sintaksës gjenerative, mbi njësinë që normalisht i bashkohet treguesit të shquarsisë/pashquarsisë në pozicionin kokë të sintagmës determinative. Në rastin në fjalë, objekt i elipsës nuk është vetëm koka e sintagmës emërore në pozicionin zero, por edhe ajo e sintagmës determinative, bile edhe koka e sintagmës foljore, komplement i së cilës del SD. Arsyeja e mosemërzimit të mbiemrit, ka të bëjë me faktin që mbiemri është pjesë e grupit foljor – në funksion predikativ dhe jo atributiv – dhe si i tillë nuk mund të zhvendoset drejt një pozicioni-kokë brenda SD (Skema 11). Fjalja e plotë do të ishte:

(11) *Me armiqtë i kish të hidhëta fjalët, me miqt i kish t'ëmblla fjalët.*



Skema

Ky është një rast i elipsës tekstore, e cila nuk ndikon në krijimin e kushteve për emërzimin e mbiemrit. Nisur nga saktësimi i mësipërm, e kemi më të lehtë të përcaktojmë kushtet sintaksore apo pragmatike të cilat e bëjnë të mundur ose të domosdoshëm procesin e emërzimit. Që të ndodhë emërzimi duhet të plotësohen dy kushte:

- mbiemri të jetë në funksion atributiv brenda një SD;
- emri-kokë që lëviz drejt pozicionit D⁰ të jetë objekt i elipsës.

Elipsa vepron mbi kokën emërore, kur emri përkatës mund të rrocket lehtësisht nga konteksti (12), ose kur emri-kokë është përmendur më parë në tekst (13).

- (12) *Mbasi kaluan këto ditë, mbreti shtroi një banket tjetër prej shtatë ditësh, në oborrin e kopshtit mbretëror, për të tërë popullin që ndodhej në këshqjellën e Suzës, nga më i madhi deri te më i vogli.* (Dhjata e vjetër, Ester, përkthim i Shoqërisë Biblike të Shqipërisë (Albanian Bible Society), 1994)
- (13) *Kishin tri çupa: të tria të mira. E madhja tirrte furkën, e mesmja gatuante në magje, e vogla punonte gjergjefin e bënte urdhëratat si e vogël që ishte.* (Kuteli, *Vepra letrare 2*, 1990:130-131)

Në (12) është lehtësisht e rrokshme që në nga më i madhi deri te më i vogli mbiemri ka zënë vendin e emrit *njeri*, pavarësisht se ky nuk gjendet në tekst: nga *njeriu më i madh deri te njeriu më i vogël*. Në (13) emri *çupë* gjendet në tekst dhe rimarrja e tij prej mbiemrit të emëruar është më e qartë se në (12).

Veprimi i elipsës diktohet nga parimi i ekonomisë gjuhësore (maksimat e Grice-it (1975): “mos ji më informues se sa duhet”; “bjeri shkurt (shmang proliksitetin e panevojshëm)”) dhe nga procesi konjitiv i aktivizimit të sinjaleve gjuhësore të regjistruara më parë në KP⁶ gjatë krijimit/receptimit të tekstit. Një emër që përmendet njëherë në tekst (*çupë* në 14) regjistrohet në kujtesë gjatë leximit të tij. Përsëritja e këtij emri është jo vetëm e panevojshme, por edhe e tepërt në tekstin që pason, pasi do ta bënte atë proliks. Kjo e bën elipsën të detyrueshme në ligjërim. Për më tepër, elipsa ndodh automatikisht dhe ndeshet rëndom në gjuhën e folur. Prandaj, edhe dalja e mbiemrit në pozicionin e emrit nuk mund të

⁶ KP = *kujtesë e punës*, pasi lidhet me ruajtjen dhe aktivizimin e të dhënave që ofron një tekst i caktuar gjatë procesit të leximit. Kjo dallohet nga *kujtesa afatshkurtër* (KASH), e cila ruan një numër të kufizuar fjalësh (deri në 9) gjatë procesit të leximit, si edhe nga *kujtesa e qëndrueshme*, ose *kujtesa afatgjatë* (KAGJ), e cila vepron përtej procesit të receptimit të tekstit. Një grup autorësh pranojnë vetëm kujtesën afatshkurtër dhe atë afatgjatë, një grup tjetër pranon edhe kujtesën e punës (shih: Schwarz-Friesel & Consten, 2014:66; Dauti, 2017:83-84).

shihet si dukuri fakultative, si krijim individual, apo për qëllime stilistike. Një vlerë të tillë do ta fitonte, në qoftë se ndërtimi me praninë e emrit-kokë – me mungesë emërzimi të mbiemrit – do të kishte vlerën e ‘ndërtimit normal’⁷.

- (14) *Mbasi kaluan këto ditë, mbreti shtroi një banket tjetër prej shtatë ditësh, në oborrin e kopshtit mbretëror, për të tërë popullin që ndodhej në kështjellën e Suzës, nga njeriu më i madh deri te njeriu më i vogël.*

Por një ndërtim i tillë (14) nuk tingëllon fort i pranueshëm. Është ndërtimi me mbiemër të emërzuar ai që për një shqipfolës tingëllon më normal.

Emërzimi i mbiemrit mund të fitojë vlerë stilistike, p.sh., kur një tekst fillon me një mbiemër të emërzuar, sikurse tregimi i Kutelit *Natë muaji maj* në (15), çka e gjallon kureshtjen e lexuesit.

- (15) *Na ish njëherë një i mirë me mall e gjë shumë e na bënte dasmën e të birit.* (Kuteli, *Vepra letrare* 2, 1990:226)

Duke qenë se jo të gjitha rastet e emërzimit të mbiemrit janë të motivuara stilistikisht (shembulli 14), përdorimi i tij me vlerë stilistike nuk mund të shihet si shkak i dukurisë. Në mbështetje të kësaj vjen edhe pohimi se “emërzimi është karakteristikë e gjuhës dhe e stilit popullor” (Prifti, 1976:67), që do të thotë se dukuria ka lindur në komunikimin e përditshëm, aty ku veprimi i parimit të ekonomisë gjuhësore, për pasojë edhe i elipsës, është më i pranishëm, e prej këtej është shfrytëzuar edhe në format e tjera të ligjëritimit.

BIBLIOGRAFI

- Beaugrande, R. De & Dressler, U., *Einführung in die Textlinguistik*, Nimeyer, Tübingen, 1981.
- Buchholz, O. & Fiedler, W., *Albanesische Grammatik*, VEB Verlag Enzyklopädie, Leipzig, 1987.
- Camaj, M., *Albanian Grammar*. Wiesbaden: Harrassovitz, 1984.
- Cipo, K., *Gramatika shqipe*. Instituti i Shkencave, Tiranë, 1949..
- Dauti, L., *Hyrje në gjuhësi teksti*, ILAR, Tiranë, 2017.

⁷ Të qenët ndërtim normal (ndërtim i rregullt gramatikor) përcaktohet nga shkalla e pranueshmërisë së ndërtimit prej folësve të një gjuhe (informatorëve). Ndërtimi me shkallë të lartë pranueshmërie është normal, ndërsa ai me shkallë të ulët pranueshmërie është më pak normal (Quirk & Svartrik, 1966:9; sipas: de Beaugrande & Dressler, 1981:136).

- Dhrimo, A., *Substantivimi i mbiemrit*, në: “Studime filologjike”, 1971/1, f. 79-93.
- Frashëri, S. (1886). *Shkronjëto e gjuhës shqip* në: “Sami Frashëri, Vepra 2” f. 96-215, Tiranë, 1988.
- Gramatikë e gjuhës shqipe, 1*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002.
- Grice, H. Paul., *Logic and conversation* në Cole, P., and J.L. Morgan (eds.), “Speech Acts”, Academic Press, New York, 41–58, 1975.
- Karapinjalli, M. & Luniku, R., *Tekst ushtrimesh gjuhësore (morfologji)*. Rama Graf, Elbasan, 2011.
- Koleci, F. & Turano, G., *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*. ShBLU, Tiranë, 2011.
- Kristoforidhi, K. (1882). *Gramatika e gjuhës shqipe sipas dialektit toskë* në “Konstandin Kristoforidhi, Vepra 1”, SILVER 2001, f. 53–243.
- Memushaj, R., *Gramatika gjenerative, ShBLU, Tiranë, 2008*.
- Memushaj, R., *Morfonologji e eptimit të shqipes standarde*. Botim i dytë. Infobotues, Tiranë, 2012.
- Pekmezi, Gj., *Grammatik der Albanesischen (Laut- und Formenlehre)*. Wien, 1908.
- Prifti, S., *Substantivimi*, në: “Studime filologjike”, 1976/4, f. 63-68.
- Resuli, N., *Grammatica Albanese*. Pátron Editore, Bologna, 1985.
- Rrota, J., *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore (botimi I)*. Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
- Schwarz-Friesel, M. & Consten, M., *Einführung in die Textlinguistik*, WBG, Darmstadt, 2014.
- Sheperi, I. D., *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe – sidomòs e toskërishtes* (për shkolla të mesme), Vlorë, 1927.

SUMMARY

CONTEXTUAL NOMINALIZATION OF THE ADJECTIVE IN ALBANIAN LANGUAGE

We can distinguish three groups of nominalised adjectives in Albanian: (i) Adjectives that can be nominalised inside a certain text – contextual names; (ii) Adjectives that can be nominalised in a certain situation of communication – situational names; (iii) Adjectives that can be nominalised independently from the text or the situation of communication – adjectival names.

In this article we offer a different approach from the prescriptive one of the traditional grammar to the case of the first group of nominalised adjectives

in Albanian. Our main goal is to explain how the process of contextual nominalisation is realised and under which syntactic restrictions it takes place. To get nominalised an adjective must be in attributive relation to the noun inside a DP, and the noun itself must be object of ellipsis. In that case the adjective moves to the D^0 position of DP to join there the definite or indefinite determiner. This leads to a hybrid construction, in which the adjective has joined the flective endings of the name. This construction can be subject of the sentence, complement, object and prepositional complement. The adjective can be modified by comparative adverbs (*më i madhi* “the bigger”) which is an indication of its adjectival status, while the modification by adjectives and relative clauses is an indication of noun status (*i vogli i qethur shkurt, e madhja që rrinte ulur*). This construction is obtained in discourse, so we have to take in consideration textual factors that influence the process of nominalisation.

